

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-SË PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- Këshilli Drejtues i RTSH-së ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur imazhin e RTSH-së, si një institucion serioz publik kombëtar, siç e përcakton ligji.
- RTSH-ja, sidomos gjatë vitit 2009 e në vazhdim, po punon intensivisht për përmirësimin e parametrave cilësorë në shërbim të telespektatorëve.
- Këshilli Drejtues dhe titullarët e RTSH-së janë përpjekur për të realizuar rinovimin e teknologjisë dhe dixhitalizimin, me qëllim që RTSH-ja të jetë konkurrenti kryesor në tregun mediatik, por akoma nuk ka mundur të plotësojë këtë objektiv shumë të rëndësishëm.
- Kërkohet një mbështetje akoma më e madhe nga Buxheti i Shtetit për përmirësimin e teknologjisë radiotelevizive dhe kualifikimin teknik e profesional të personelit të RTSH-së.
- Kërkohet rishikimi i kuadrit ligjor për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë së këtij institucioni.

Kuvendi vlerëson se:

- Janë bërë përpjekje serioze për përmirësimin e strukturës programore të RTSH-së, duke fituar terren në tregun mediatik, duke nxitur ndjeshëm format sa më gjithëpërfshirëse të dialogimit qytetar, gjë që ka mundur rritjen numerike të dëgjuesit dhe teleshikuesit publik ndaj këtij operatori.
- Risi për këtë vit janë, sidomos, futja e edicionit të lajmeve në anglisht dhe të edicionit informativ për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara shqisore.
- Në programet e RTSH-së janë bërë përpjekje në drejtim të rritjes së pavarësisë editoriale.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 29.9.1993 “Për kalimin në inventar të pushtetit lokal të godinave, aparaturave dhe linjave të pikave përsëritëse” ka penguar mirëmbajtjen dhe ruajtjen e këtyre pajisjeve, për shkak të paqartësive dhe dublimeve të kompetencave ndërmjet pushtetit vendor apo Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Për sa më sipër, Kuvendi kërkon nga Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të RTSH-së:

- Në zbatim të nenit 88 pika 6 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, hedhjen e shortit për përcaktimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së.
- Të bëjnë propozimet konkrete, në lidhje me projektligjin “Për transmetimet me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë në konsideratë dhe sugjerimet e Komisionit Europian dhe të Këshillit të Europës.
- Me qëllim që të realizohet përmirësimi teknologjik i infrastrukturës teknike të RTSH-së dhe kualifikimi profesional i punonjësve, në mbështetje të nenit 115 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Drejtues dhe Drejtoria e Përgjithshme e Radiotelevizionit Shqiptar të rrisin rendimentin e punës së strukturave të RTSH-së për rritjen e buxhetit të këtij institucioni mjaft të rëndësishëm, duke siguruar fondet financiare jo vetëm nga Buxheti i Shtetit, taksë mbi aparatën marrës, por edhe nga kontratat me palët e treta për transmetime të ndryshme, shërbime të tjera programesh, botimet e prodhimeve muzikore, video, audio, librave, gazetave, revistave që lidhen me programet etj.
- Të përgatisin personelin teknik, nëpërmjet trajnimeve profesionale dhe rekrutimit të njerëzve të rinj të aftë, që i përgjigjen stadi të teknologjisë moderne.

29 prill 2010